

STATUTI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
**INDRIT GJUZI SH.P.K.**

HYRJE

**Baza ligjore :**

- Ligjin 9723 date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit “
- Ligjin 9901 date 14.04.2008” Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “
  
- Sot date 19.04.2021 , ne Tirane , Une themeluesi i vetem **Indrit Gjuzi** , i datelindjes 16.10.1994 , lindur ne Tirane , madhore, me zotesi te plote per te vepruar, me gjendje civile beqare , me shtetesi shqiptare, me nr personal J41016043J , ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008” Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “ , Ligjin 9723 date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, kam krijuar nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emrin **INDRIT GJUZI shpk** , si me poshte :

**Neni 1**

EMERIMI I SHOQERISE

Emertimi i shoqerise eshte **INDRIT GJUZI sh.p.k.**

**Neni 2**

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht Ligjin 9901 date 14.04.2008 “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “ , Ligjin 9723 date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit, “  
aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise si dhe dispozitat e statutit te shoqerise .

**Neni 3**

Shoqeria **INDRIT GJUZI sh.p.k.** eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me ortak te vetem **Indrit Gjuzi** i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pa shlyer te kontributeve te nenshkruara . Kontributet e ortakut perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

**Neni 4**


Selia e shoqerise eshte Rruga Bardhyl, pallati Biffer, kati 0, dyqani Nr.5

**Neni 5**

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria **INDRIT GJUZI sh.p.k.** ka per objekt kryesor te veprimtarise se saj ;

Tregtim me pakice te mallrave si dhe shitje online te artikujve te ndryshem per kozmetike



## Neni 6

Kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te shoqerise eshte me afat te pa kufizuar , duke filluar ky afat nga data e marjes se certificate se regjistrimit ne QKB , per njohjen dhe regjistrimin e shoqerise si person juridik.

Me vendim te asamblese se ortakeve (  $\frac{3}{4}$  ) ortakeve , kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te shoqerise mund te ndryshoje , dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim Qendres Kombetare te Biznesit per te bere shenimet e nevojeshme ne Regjistrin e Shoqerive Tregetare .

## Neni 7

Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne te gjitha teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, gjithashtu ajo mund te hape , filiale, dege, ose perfaqesi ne rethe te ndryshme te republikes se Shqiperise , apo ne shtete te tjera , ne perputhje me legjislacionin e vendeve perkatese .

## Neni 8

### KAPITALI DHE PJESET

Kapitali themelor fillestar i shoqerise eshte 100 ,000 leke (njqind mije) leke , i cili perben 1 ( nje ) kuote .

Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet , zvogelohet me vendim te mare prej  $\frac{3}{4}$  nga Asambleja e ortakeve .

## Neni 9

### KONTRIBUTET

Kapitali themeltar i shoqerise **INDRIT GJUZI** sh.p.k. zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise **Indrit Gjuzi** , ne masen 100 % dhe i perket teresisht atij.

Vlera e kapitalit themeltar te shoqerise eshte shlyer plotesisht me kontributin e ortakut te vetem .


Shoqeria tregetare mund te leshoje nje certificate per te vertetuar zoterimin e kuotes se kapitalit . Kjo certificate leshohet ne emer te personit apo te personave qe zoterojne kuoten dhe nuk perben leter me vlere.

Per nevoja te punes dhe te ushtrimit te aktivitetit te saj shoqeria mund te çele llogari ne çdo banke te njohur me ligj , qofte kjo private ose shteterore .

## Neni 10

### MENYRA E FITIMIT DHE KALIMIT TE KUOTAVE

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet ;



- Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- Shitblerjes
- Trashegimise
- Dhurimit

-Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj .

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate , kontrata duhet te behet me akt noterial .

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme nepermjet ortakeve , kur shoqeria ka me shume se nje ortak.

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri , me vendim te mare me shumicen e ortakeve qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit themeltar .

Ne rast kur njeri apo disa nga ortaket deshirojne te trasferojne pjeserisht apo plotesisht pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar tek te tretet , me pare duhet qe oferta per shitje tu behet ortakeve te tjere te shoqerise , me te njejtat kushte qe do ti behet te treteve .

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rjedhin nga zoterimi i kuotes , nga casti i kalimit te kuotave , deri ne castin e regjistrimit te kalimit .

Shoqeria regjistron kalimin e kuotes , sipas nenit 43 te ligjit 9723, date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit " .

## Neni 11

### MAREDHENIET NDERMJET SHOQERISE DHE ORTAKEVE

Ortaket kane te drejte te ndajne pjesen e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise , fitimi u shperndahet ortakeve ne raport me kuotat e zoteruara .

Shoqeria mund tu shperndaje fitime ortakeve , vetem nese pas pagimit te dividendit ;

-Aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj

-Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim.

Administratoret e shoqerise leshojne nje certificate te aftesise paguese ne rast te shperndarjes se fitimeve ortakeve nga shoqeria. Ata pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e e certificates se aftesise paguese , pergjigjen personalisht perpara shoqerise per kthimin e dividenteve te shperndare.

## Neni 12

### ORGANET E SHOQERISE

( asambleja e pergjitheshme, te drejtat dhe detyrimet )

1-Asambleja e pergjitheshme eshte pergjegjese per marjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme ;

a-Percaktimin e politikave tregetare te shoqerise ;

b-ndryshimin e statutit;

c-emerimin e shkarkimin e administratoreve ;

ç-emerimin e shkarkimin e likujdvesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar

d-percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat “ c”, “ ç” te kesaj pike ;

dh-mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret , perfshire pergatitjen e pasqyrave finaziare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; e-miratimin e pasqyrave finaziare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise ;

e-zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;

f-pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre ;

g-perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera nga administratoret ;

gj-riorganizimin dhe prishjen e shoqerise ;

h-miratimin e regullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese ;

i-ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

2-Asambleja e pergjitheshme mer vendime per ceshtjet e percaktuara ne shkronjat “ e” dhe “ e” te pikes 1 , pas ,marjes dhe shqyrtimit te dokumentave perkatese .

3-Nese shoqeria zoterohet nga nje ortak , te drejttat dhe detyrimet e asamblese ushtrohen nga ortaku i vetem. Te gjitha vendimet e mara nga ortaku i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve , te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen . Duhet regjistruar ne vecanti , por pa u kufizuar ne to vendimet per ;

a-miratimin e pasqyrave finaziare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise ;

b-shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve ;

c-investime;

ç-vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise .

Vendimet e pa regjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pa vlefeshme .Shoqeria nuk mund ti kundrejtoje pavlefshmerine te tretit , qe ka fituar te drejta ne mirebesim , pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur djeni per pavlefshmerine , apo ne baze te rethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur djeni per te .

## MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHESHME

1-Asambleja e pergjitheshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligji 9901 date 14.04.2008 , ne ligje te tjera dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojeshme per te mbrojtur interesat e shoqerise . mbledhja e zakoneshme mblidhet te pakten nje here ne vit.

2-Asambleja e pergjitheshme thiret nga (administratoret) administratori apo ortaket parashikuar nga neni 84 i ligjit 9901 date 14.04.2008.

3-Asambleja e pergjitheshme thiret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjeteme finaziare , rezulton se ekziston reziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

4-Asambleja e pergjitheshme thiret kur shoqeria propozon te shese apo disponoje ne menyre tjeter active , te cilat kane nje vlere me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise , qe rezulton ne pasqyrat e fundit finaziare te certifikuara .

5-Asambleja e pergjitheshme thiret kur shoqeria , brenda dy viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri , qe kane vlere me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise , qe rezulton ne pasqyrat e fundit finaziare te certifikuara.

6-Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 e 5 sa me siper asamblese se pergjitheshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pa varur.

7-Dispozitat e pikes 6 sa siper , nuk zbatohen nese blerjet , sipas pikes 4 e 5 , kryhen ne burse ose jane pjese e veprimeve te perditeshme te shoqerise dhe behen ne

kushte normale tregu . Gjithashtu keto dispozita nuk zbatohen ne rastin kur shoqeria zoterohet nga nje ortak i vetem.

#### Menyra e thirjes

Asambleja e pergjitheshme thiret nepermjet nje njoftimi me shkrese , nepermjet postes elektronike , ose te ndonje forme tjeter te pa kontestueshme . Ne njoftim sakesohet vendi, data, ora, rendi i dites dhe u dergohet te gjithë ortakeve jo me vone se 7 dit perpara dates se mbledhjes .Kur nuk eshte respektuar procedura sa me siper ajo ( asambleja ) mund te mare vendime nese te gjithë ortakët jane dakort , pavaresisht paregullise .

#### Kerkesa nga ortakët e pakices

Ortakët te cilet perfaqesojne 5 % te totalit te votave ne asamblene e pergjitheshme , mund ti drejtojne nje kerkese administratorit me shkrim per te thirur asamblene e pergjitheshme ose perfshirjen e ceshtjeve te posacme ne rendin e dites .Kerkesa duhet te jete e motivuar duke shprehur arsyet , objektivat, ceshtjet per te cilat asambleja duhet te mare nje vendim.

Nese ne kundertshtim me paragrafin sa me siper asambleja e pergjitheshme nuk thiret , ose ceshtja e kerkuar nuk futet ne rendin e dites secili prej ortakeve qe ka bere kerkesen ka te drejte;

a-te ngreje padi ne gjykate per te deklaruar shkeljen e detyrimit te besnikerise , nese administratorët nuk permbushin kerkesat e ortakeve brenda 15 diteve

b-ti kerkoje shoqerise blerjen e kuotave , te zoteruara prej tyre .

#### Neni 13

##### Perfaqesimi ne asamble

1-Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjitheshme , ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete .

2-Administratorët e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjitheshme .

3-Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjitheshme , e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### Neni 14

##### Kourumi

1-Ne rastin e marjes se vendimeve , qe kerkojne nje shumice te zakoneshme , asambleja e pergjitheshme mund te mare vendime te vlefeshme vetem nese marin pjese ortakët me te drejte vote , qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave .Ne rastin kur asambleja e pergjitheshme duhet te vendose per ceshtje , te cilat kerkojne shumice te kualifikuar , sipas nenit 87 te Ligjit 9901 date 14.04.2008 “ Per tregetaret dhe shoqerite tregetare “ , ajo mund te mare vendime te vlefeshme vetem nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht , votojne me shkrese , apo mjete elektronike , sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji .

2-Nese asambleja e pergjitheshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungese se kuorumit te permbendur ne piken 1 sa siper , asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite .

#### Marja e vendimeve

1-Asambleja e pergjitheshme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave te ortakeve pjesemares ;  
-Per ndryshimin e statutit  
-Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar  
-Shperndarjen e fitimeve  
-Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise .

2-Me perjashtim te rasteve ku parashikohet ndryshe ne ligjin 9901 date 14.04.2008 “ Per tregetaret dhe shoqerite tregetare “ , per ceshtjet e tjera te renditura ne nenin 81 te ketij ligji , asambleja e pergjitheshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemares .

Çdo kuote jep te drejten e nje vote .

Asambleja e pergjitheshme mund te vendose nisjen e nje hetimi te posacem per paregullsite pergjate veprimeve te themelimit te shoqerise apo te ushtrimit te veprimtarise tregetare . Hetimi kryhet nga nje ekspert I fushes perkatese .

#### Neni 15

##### Procersverbalet e mbledhjes se asamblese

Te gjitha vendimet e asamblese se pergjitheshme duhet te regjistrohen ne procersverbal .

Administratoret pergjigjen per ruajtjen e kopjeve te procersverbaleve te mbledhjeve te asamblese se pergjitheshme .

Procersverbali duhet te permbaje daten e vendin e mbledhjes , rendin e dites , emrin e kryetarit e te mbajtesit te procersverbalit , rezultatet e votimit .

Procersverbalit i bashkelidhet dhe lista e pjesemaresve , si dhe akti i thirjes se asamblese se pergjitheshme.Procersverbali nenshkruhet nga kryetari dhe mbajtesi i procersverbalit .

##### Shfuqizimi i vendimeve te pa regullta dhe demshperblimi

1-Asambleja e pergjitheshme ka te drejte ti kerkoje gjykates perkatese shfuqizimin e vendimeve te administratoreve kur keto perbejne shkelje te rende te ligjit ose statutit .

2-Ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5 % te totalit te votave ne asamblene e shoqerise , opo secili prej kreditoreve te shoqerise mund ti kerkoje asamblese se pergjitheshme ngritjen e padise si me siper , brenda 30 diteve pas refuzimit nga asambleja per ngritjen e padise , kane te drejte te ngrene padi drejtperdrejt perpara gjykates kopetente per shfuqizimin e vendimit te administratorit . Nese asambleja e pergjitheshme nuk mer nje vendim, brenda 60 diteve nga data e kerkeses , kerkesa e ortakeve apo kreditoreve vleresohet e refuzuar.

3-Ne rastet kur shoqeria ngre padi ne gjykate ajo perfaqesohet nga nje perfaqesues i zgjedhur nga asambleja e pergjitheshme.

##### Te drejtat e lidhur me kuoten

Ortaku qe pengohet te ushtroje te drejtat qe I rjedhin nga zoterimi I kuotes se shoqerise ka te drejte ti kerkoje gjykates te urdheroje ndalimin e cenimit apo

shperblimin e demit te shkaktuar si pasoje e cenimit te ketyre te drejtave . Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjeteve nga casti I cenimit .

## Neni 16

### ADMINISTRATORET

Emerimi, shkarkimi , te drejtat dhe detyrimet

Asambleja e pergjitheshme emerion nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit nuk mund te jete me i gjate se 5 vjet , me te drejte riperseritje . Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren kombetare te regjistrimit .

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te ;

a-kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise , duke zbatuar politikat tregetare , te vendosura nga asambleja e pergjitheshme ;

b-perfaqesojne shoqerine tregetare ;

c-kujdesen per mbajtjen e sakte e te regullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise ;

ç-pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor , bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve , i paraqesin keto documenta perpara asamblese per miratim;

d-krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rethanat , qe kercejne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise ;

dh-kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise , sic parashikohet ne ligjin per Qendren kombetare te Regjistrimit;

e-raportojne perpara asamblese se pergjitheshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregetare;

e-kryejne detyra te tjera te percaktuara ne statut e ligj

Administratoret jane te detyruar te thersin asamblene e pergjitheshme.

Ne rastet e e emerimit te me shume se nje administrator ata e administrojne bashkarisht shoqerine .

Asambleja e pergjitheshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakoneshme . Statuti apo mareveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte .

Perveç dispozitave te pergjitheshme te detyrimit te besnikerise , sipas neneve 14, 15, 17, 18, te Ligjit 9901 dt 14.04.2008 “ Per tregetaret dhe shoqerite tregetare “

Administratoret detyrohen;

-te kryejne detyrat e tyre te percaktuara ne ligj ose ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi ;

-te ushtrojne kopetencat qe u njihen ne ligj ose ne statut vetem per aritjen e qellimeve dhe objektive te shoqerise ;

-te vleresojne me pergjegjesi ceshtjet , per te cilat meret vendim ;

- te parandalojne dhe menjanojne rastet e konfliktit , prezent apo te mundshem , te interesave personale me ato te shoqerise

- -te garantojne miratimin e mareveshjeve sipas dispozitave te pikes 3 , neni 13 i ligjit “ Per tregetaret dhe shoqerite tregetare “

- te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem Administratoret , gjate kryerjes se detyrave te tyre , pergjigjen ndaj shoqerise per cdo veprim apo mos veprim , qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise

tregetare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese , veprimi ose mos veprimi eshte kryer ne mirebesim.

Nese administratoret veprojne ne kundershkrim me detyrat dhe shkelin standartet profesionale jane te detyruar ti demshperblejne shoqerise demet , qe rjedhin nga kryerja e shkeljes , si dhe ti kalojne cdo fitim personal qe ata ose personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te pa regullta .

Administratoret kane baren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te regullt e sipas standarteve te kerkuara .

Ne menyre te vecante , por pa u kufizuar ne to , administratoret jane te detyruar ti demshperblejne shoqerise demet e shkaktuara , nese, ne kundershkrim me dispozitat e ketij ligji , kryejne veprimet e meposhteme;

a-u kthejne ortakeve kontributet ;

b-u paguajne ortakeve interesa apo dividente ;

c-u shpendajne aktivet shoqerise ;

ç-lejojne qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregetare , kur ne baze te gjendjes financiare , duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet ;

d-japin kredi

### **Neni 17** Perfaqesimi

Shoqeria tregetare perfaqesohet sipas regullave te percaktuar ne ligjin 9901 dt 14.04.2008 “ Per tregetaret dhe shoqerite tregetare “ , dhe dispozitave te statutit . Perfaqesimi ligjor i shoqerise eshte i vlefshem per cdo veprim gjyqesor apo jashte gjyqesor .

Perfaqesuesit ligjore zbatojne te gjitha kufizimet e tagreve te perfaqesimit te percaktuara ne statut , apo te miratuara nga organet perkatese te shoqerise .Me perjashtim te rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur djeni per kufizimin apo ne baze te rethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur djeni per te, kufizimi i kopetencave nuk mund ti kundrejtohet paleve te treta .

Veprimet e kryera nga perfaqesuesit ligjore te shoqerise jane te detyrueshme per shoqerine edhe nese keto tejkalojne objektin e saj , me perjashtim te rastit kur keto veprime shkojne pertej tagrave te perfaqesimit qe u jep ligji apo lejon tu jepen perfaqesuesve . Keto veprime nuk jane detyruese per shoqerine nese shoqeria provon se i treti ka pasur djeni se aki tejkalon objektin e saj , apo ne baze te rethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur djeni per te.

Cdo paregullsi ne emerimin e perfaqesuesit ligjor nuk perjashton apo kufizon pergjegjesine e shoqerise ndaj palve te treta , pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur djeni per paregullsin, apo ne baze te rethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur djeni per te.

Kufizimet e tagreve te perfaqesimit te administratoreve i kundrejtohen paleve te treta ne perputhje me dispozitat e nenit 12 te Ligjit 9901 dt 14.04.2008 “ Per tregetaret dhe shoqerite tregetare “.

Tagret e perfaqesimit te administratoreve dhe cdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Shperblimet e administratoreve percaktohen me vendim te zakonshem te asamblese se pergjitheshme.

### **Neni 18**





## EMERTIMI I PARE I ADMINISTRATORIT

**Administrator** i shoqerise **INDRIT GJUZI sh.p.k.** per periudhen 4 vjeçare emerohet **Indrit Gjuzi** , i cili eshte edhe ortak i vetem i shoqerise .

### **Neni 19** EKSPERTE KONTABEL TE AUTORIZUAR

Ne rast nevoje si dhe kur kerkohet nga ligji , kontrolli kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar , i emeruar per dy vite finaziare me mundesi rizgjedhjeje nga ortakët qe perfaqesojne  $\frac{1}{2}$  e kapitalit themeltar.

Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi i tij , ne rast se verehen gabime abuzime, ose behet e pa mundur kryerja e detyres.

### **Neni 20** VITI FINANCIAR

Çdo vit financiar fillon nga 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor .

### **Neni 21**

Llogarite vjetore

Llogarite vjetore , inventari , raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontatabel i autorizuar , miratohen nga asambleja me vendimin e ortakeve qe zoterrojne mbi  $\frac{1}{2}$  e kapitalit themeltar.


Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar .

### **Neni 22** DIVIDENTET

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve asambleja e ortakeve percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividendeve mbi fitimin proporcionalisht me perqindjen e pjesemarjes se gjithesecilit ne shoqeri . Fitimi qe do te ndahet ndermjet ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar , perbehet nga fitimi i vitit financiar te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem ( 5% e fitimit te çdo viti , derisa ky fond te arije vleren  $\frac{1}{10}$  e kapitalit themeltar ) dhe nga ana tjeter i jane zbritur ose i jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartuara nga vitet e mepareshme .

### **Neni 23** PRISHJA E SHOQERISE

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar priset;  
a-kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;  
b-me vendim te asamblese se pergjitheshme;



c-me hapjen e procedurave te falimentimit ;  
ç-nese nuk ka kryer veprimtari tregetare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar  
pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 dt  
3.5.2007 “ Per Qendren kombetare te Regjistrimit “ ;  
d-me vendim te gjykates ;  
dh- per arsye te tjera te parashikuara ne statut.

Shoqeria nuk priset kur njeri nga ortakët falimenton , behet i pa afte ose vdes ,  
por vazhdon aktivitetin me ortakët e tjere qe kane mbetur si dhe me trashegimtarët e  
radhes se pare te ortakut qe vdes , pasi ata te jene miratur me pare nga asambleja e  
ortakeve .

Administratoret regjistrojne prishjen e shoqerise prane Qendres kombetare te  
Regjistrimit , ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723 dt 3.5.2007 “ Per Qendren  
kombetare te Regjistrimit “. Nese prishja e shoqerise behet me vendim gjykate ,  
gjykata , ne perputhje me nenin 45 te ligjit nr. 9723 dt 3.5.2007 “ Per Qendren  
kombetare te Regjistrimit “ ia njofton vendimin Qendres Kombetare te Regjistrimeve  
per regjistrim.

## Neni 24

### Largimi dhe perjashtimi i ortakut

1.Ortaku mund te largohet nga shoqeria nese ortakët e tjere ose shoqeria kane  
kryer veprime ne dem te tij , nese eshte penguar te ushtroje te drejtat e tij , nese  
shoqeria i ka ngarkuar detyrime te pa arsyeshme apo per shkaqe te tjera , qe e bejne te  
pa mundur vazhdimin e ortakerise.

2.Ortaku qe kerkon largimin, duhet te njoftoje shoqerine me shkrim , si dhe te  
parashtroje shkaqet e largimit .

3.Administratoret duhet te therasin mbledhjen e asamblese se pergjitheshme  
menjehere pasi te kene mare dijeni per njoftimin e largimit , sipas pikes 2 te ketij neni  
, per te vendosur nese ortakut do ti likuidohet kuota , si pasoje e largimit per shkaqe te  
arsyeshme .

4.Ortaku ka te drejte te ngraje padi ne gjykate ndaj shoqerise per likujdimin e  
kuotes , si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme , nese pas njoftimit te largimit  
asambleja e pergjitheshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si te arsyeshme shkaqet e  
largimit dhe likujdimin e kuotes .

5.Ortaku qe kerkon largimin nga shoqeria , detyrohet te demshperbleje  
shoqerine per demet e shkaktuara , nese rezulton se largimi eshte kryer ne baze te  
shkaqeve te pa arsyeshme.

6.Ortaku qe largohet ka te drejte te ngrere padi ndaj shoqerise dhe /ose  
ortakeve te tjere qe shkaktuan largimin e tij dhe te kerkoje ndaj tyre , ne menyre  
solidare , shperblimin e demit te pesuar .

### Perjashtimi i ortakut

.Ne baze te nje vendimi te zakonshem , asambleja e pergjitheshme mund ti  
kerkoje gjykates perjashtimin e ortakut , nese ai nuk ka shlyer kontributin e tij ,sipas  
parashikimeve te statutit ose nese ekzistojne shkaqe te tjera te arsyeshme per kete  
perjashtim .

.Konsiderohen shkaqe te arsyeshme per perjashtimin e ortakut , sipas pikes 1 te  
ketij neni , por pa u kufizuar ne to , rastet kur ortakut ;

a-me dashje apo pakujdesi te rende i shkaktonte demet shoqerise ose ortakeve te  
tjere ;

b-me dashje apo me pakujdesi te rende shkel statutin ose detyrimet e percaktuara me ligj;

c-perfshihet ne veprime , te cilat e bejne te pa mundur vazhdimin e maredhenieve midis shoqerise tregetare dhe ortakut ;ose

ç-me veprimet e tij demton ose pengon ndjeshem veprimtarine tregetare te shoqerise .

Shoqeria ka te drejte ti kerkoje ortakut te perjashtur shperblimin e demit te shkaktuar nga veprimet qe kane sjelle perjashtimin.

Ortaku ka te drejte ti kerkoje shoqerise shperblimin e demit te pesuar , nese kerkesa per perjashtim nuk eshte e bazuar.

Ortaku nuk ka te drejte ti kerkoje shoqerise likuidimin e kuotes , nese ai perjashtohet per shkaqe te arsyeshme , por, nese shoqeria ngre ndaj tij padi per shperblim demi , ortakut ka te drejte te kompensoje cdo shume , qe do te kishte te drejte te perfitonte ne cilesine e likujdimit te kuotes , me demin e kerkuar nga shoqeria .

Te gjitha te drejtat , qe rjedhin nga cilesina e ortakut ne shoqeri , shuhen ne daten e largimit ose te vendimit te formes se prere te gjykates per largimin ose perjashtimin .

Statuti nuk mund te perjashtoje apo kufizojte te drejten e ortakut per tu largura nga shoqeria dhe te drejten e shoqerise per te perjashtuar ortakun.

## **Neni 25**

### **Likujdimi ne gjendjen e aftesise paguese**

Ne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar , likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga asambleja e pergjitheshme. Nese asambleja e pergjitheshme nuk mer nje vendim per emerimin e likujduesve , brenda 30 diteve pas prishjes , cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates , per te caktuar nje likujdues .

Kur shoqeria tregetare priset me vendim gjykate, likujduesi emerohet nga gjykata .

Me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi , prishja e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese , sipas neneve 190 deri 205 te Ligjit 9901 dt 14.04.2008 “ Per tregetaret dhe shoqerite tregetare “.

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj . . Per kryerjen e ketij procesi Asambleja emerone nje likujdues i cili i paraqet asaj raportin e likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre .

Ne fund te procesit te likujdimit asambleja vendos me vendimin e ortakeve qe zoterojne te pakten  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit themeltar , mbi bilançin perfundimtar e financiar , mbi aktin e regullshmerise se punes se likujduesit dhe oper mbylljen e procesit te likujdimit .

Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates , likujduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve proporcionalisht me pjeset qe ato zoterojne ne kapitalin themeltar .

## **Neni 26**

MOSMAREVESHJET



Te gjitha mosmareveshjet qe mund te linden gjate ekzistences se shoqerise , ose gjate periudhes se likuidimit midis ortakeve , ndermjet shoqerise dhe ortakeve , do ti paraqiten per zgjidhje gjykates kopetente .

#### **Neni 27**

Per çeshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete statut do te zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar ne fuqi .

Ky statut redaktohet ne tre kopje orgjinale dhe nenshkruhet regullisht nga ortaku i vetem I shoqerise **INDRIT GJUZI** sh.p.k. .

ORTAKU

**Indrit Gjuzi**

